URDHËR
Nr. 50, datë 28.3.2023

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 9887/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar; nenet 9, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.1.2023, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", si dhe Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale te znj. Besa Velaj me detyrë Drejtore e Kabinetit.
2. Delegimin e kompetencave të titullarit, në cilësinë e nëpunësit autorizues, te znj. Blerta Nerguti, me detyrë Drejtore e Çështjeve Juridike dhe Integrimit, për kryerjen e disa detyrave specifike, si vijon:

- Urdhëron kryerjen e pagesave;
- Urdhëron nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte;
- Çdo veprim tjetër të kërkuar në lidhje me Drejtorinë e Thesarit, Tiranë.

3. Kompetencat dhe detyrat e deleguara te funksionarët e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri do të ushtrohen për periudhën nga data 3.4.2023 deri më datë 7.4.2023.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi